

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

UJESJELLES-KANALIZIME SH.A- SARANDE

Sarande, me 14.04.2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Për : **“A.91” SH.P.K**

NIPT J64505806V

Procedura e prokurimit : Kerkese per propozim

Numri i references se procedures : **REF-53826-03-11-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës : **“RIKONSTRUKSIONI I PUSIT NR. 1 VRION”**

Fondi limit : **1,226,577(nje milion dyqind njezet e gjashtemije e peseqind e shtatedhjete e shtate) leke pa tvsh**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit : çmimi më i ulët

Publikime të mëparshme : **Buletini i Njoftimeve Publike nr. 12, date 17 Mars 2020**

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “NEAL-86” shpk Nipt K04814851T me oferte 1,078,500 (leke pa TVSH)
2. “2Z KONSTRUKSION” shpk Nipt J63229466K me oferte 1,080,800 (leke pa TVSH)
3. “A-91” shpk Nipt J64505806V me oferte 1,181,000 (leke pa TVSH)

Jane s.kualifikuar operatorët ekonomikë me argumentat si me poshte :

1. Operatori NEAL-86 shpk

Kriteret e Vecanta te Kualifikimit

Per Piken 2.2.1

Per te provuar pervojen e meparshem operatori ekonomik ka dorezuar dokumentacion per objektin

“Ndertim magazine me kontsruksion metalik ne Nenstacionin Elbasan1”

Nisur nga dokumentacioni i paraqitur nga OE “NEAL-86” shpk rezulton se

1. Ky objekt eshte ne përputhje me natyrën e objektit te prokuruar nga Autoriteti Kontraktor, por nga analiza e elementeve te zërave konkret, rezulton se nuk jane ne përputhje me nevojat konkrete te Autoritetit Kontraktor. Sipas situacionit te paraqitur nga OE “NEAL-86” shpk per kete procedure, rezulton te kete kryer pune te ngjashme per

punime elektrike dhe punime civile, por ne kete situacion mungon zëri konkret apo qofte dhe nje vlere e vogël e realizimit te tij, me konkretisht **F.V “Panel Soft Starter”**, i cili ne preventivin e prokuruar nga AK ze 61% te vlerës se punës, qe per AK eshte nevojshme per te njohur mundësite e operatorit ekonomik per te përmbushur me suksese kete kontrate. Ne situacionin e parqitur nga OE ka disa kaseta, automat, te instaluar ne objektin e realizuar, por nuk ka asnjë ze ku te pasqyrohet instalim paneli SofteStarter, nëpërmjet te cilit Pompat ekzistuese te këtij Pusi hynë dhe dali nga puna sipas kushteve teknike, pa u dëmtuar dhe bllokuar pune e tyre ne menyre automatike. Komisioni i Vlersimit te Ofertave konstaton se ky element i rëndësishëm, te kërkuar në preventivin e përcaktuar në dokumentat e tenderit, nuk e gjejme te pasqyruar në asnjë elemente të kontrates të dorëzuar nga operatori ekonomik, për vërtetimin e eksperiencës së mëparshme. Sa më sipër, Komisioni i Vlersimit te Ofertave gjykon se operatori ekonomik nuk vërteton se gëzon eksperiencë të mëparshme në përputhje me qellimin e objektit te procedurës së prokurimit.

2. Per Piken 2.3.2

Autoriteti Konraktor per sistemin e ambientit te jashtëm dhe largimin e barerave te këqij, ka kërkuar qe OE ofertues te paraqesi me fature nje mjete prerës **“Motokorse”**. Ndersa nga OE ekonomik eshte dorzuar dokumentacion qe disponon me fature tatimore blerje **“Motoshara”** te cilat nuk janë te pershtatshme per qellim e realizimit te zërave qe AK ka kërkuar per te realizuar ne preventiv.

3. Per Piken 2.3.4

Per kete pike AK kërkon qe ne OE ne stafin e tij teknik te kete 1 Inxhinier Elektrik. Nga shqyrtimi i dokumentacionit te dorezuar rezulton qe Inxhinierit elektrik Vatutin Kusaraj, t’i kete mbaruar **kontrata ne dt.20.02.2020**

2. 2Z KONSTRUKSION shpk

Kriteret e Vecanta te Kualifikimit

Per Piken 2.2.1

Per te provuar pervojen e meparshem operatori ekonomik ka dorezuar dokumentacion per objektin

“Rikonstruksioni i shkollës 9-vjecare Velmisht”

Nisur nga dokumentacioni i paraqitur nga OE “2Z KONSTRUKSION” shpk rezulton se

1. Ky objekt eshte ne përputhje me natyrën e objektit te prokuruar nga Autoriteti Konraktor, por nga analiza e elementeve te zërave konkret, rezulton se nuk jane ne përputhje me nevojat konkrete te Autoritetit Konraktor. Sipas situacionit te paraqitur nga OE “2z kONSTRUKSION” shpk per kete procedur, rezulton te kete kryer pune te ngjashme per punime elektrike dhe punime civile, por ne kete situacion mungon zëri konkret apo qofte dhe nje vlere e vogël e realizimit te tij, me konkretisht **F.V “Panel Soft Starter”**, i cili ne preventivin e prokuruar nga AK ze 61% te vlerës se punës, qe per AK eshte nevojshme per te

njohur mundësite e operatorit për të përmbushur me sukses këtë kontratë. Në situacionin e parqitur nga OE ka disa automat, të instaluar në objektin e realizuar, por nuk ka asnjë ze ku të pasqyrohet instalimi i panelit SofteStarter, nëpërmjet të cilit Pompat ekzistuese të këtij Pusi hynë dhe dalin nga puna sipas kushteve teknike, pa u dëmtuar dhe bllokuar punë e tyre në mënyrë automatike. Komisioni i Vlersimit të Ofertave konstaton se ky element i rëndësishëm, të kërkuar në preventivin e përcaktuar në dokumentat e tenderit, nuk e gjejmë të pasqyruar në asnjë element të kontratës të dorëzuar nga operatori ekonomik, për vërtetimin e eksperiencës së mëparshme. Sa më sipër, Komisioni i Vlersimit të Ofertave gjykon se operatori ekonomik nuk vërteton se gëzon eksperiencë të mëparshme në përputhje me qëllimin e objektit të procedurës së prokurimit.

2. Për Piken 2.3.4

Autoriteti Kontraktore ka kërkuar që OE ekonomik të paraqesë dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik për punojesi 1. Elektricitist (1) dhe 2. Puntorë/Specialist (3), për të cilët Operatori Ekonomik **nuk ka dorëzuar asnjë dokument që vërteton se e përmbushë këtë kriter.**

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë : Shoqëria “A.91” sh.p.k, me NIPT J64505806V, me adresë : Vlorë Finiq VRION, Rruga Nacionale Sarandë-Gjirokastrë, Km 10, Godinë 2-kateshe, Përballe Kantinës së Verës "Isak", se oferta e paraqitur, me vlerë 1,181,000(një milion njëqind tetëdhjetë e një mijë) lekë pa TVSH

është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Ujësjetës Kanalizime sh.a Sarandë* kopjen e sigurimit të kontratës, si dhe të paraqiteni për nënshkrimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'ju akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë më datë **03.04.2020**

Ankesa : Nuk ka patur